

Allahu i Lartësuar thotë:

????????? ?????????? ?????????????? ?????????????? ?????????????? ?????? ??????????????
???? ?????????? ?????? ?????????????? ?????? ??????? ?????????????? ?????? ?????
??????????????

“Ata që japin nga pasuria e tyre natën dhe ditën, fshehurazi dhe haptazi, do të kenë shpërblim te Zoti i tyre; ata nuk do të kenë pse të frikësohen apo pikëllohen.”[\[1\]](#)

1. Sadakaja (lëmosha) është shkak për shtimin e pasurisë dhe zgjerimin e furnizimit. Allahu i Lartësuar thotë:

????????? ?????????? ?????????????? ?????????????? ???????????????????

“Allahu ia heq çdo përfitim kamatës, kurse e rrit përfitimin e bamirësisë.”[\[2\]](#)

Kurse, Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ue sel-lem, ka thënë: *“Sadakaja nuk e pakëson pasurinë...”* (Shënon Muslimi).

2. Sadakaja është shkak për shërimin e sëmundjeve. I Dërguari i Allahut, sal-lallahu alejhi ue sel-lem, ka thënë: *“Shërojini të sëmurit tuaj me sadaka.”* (Albani e klasifikon hasen në Sahihul Xhami’).

3. Sadakaja është argument për saktësinë e imanit të atij që e jep. I Dërguari i Allahut ka thënë: *“Sadakaja është argument.”* (Shënon Muslimi).

4. Sadakaja është shkak për të arritur përkushtimin e vërtetë dhe devotshmërinë. Allahu i Lartësuar ka thënë:

??? ?????????????? ?????????? ??????? ?????????????? ??????? ?????????????? ?????? ?????????????? ???
????????? ?????????? ?????????? ?????? ??????????

“Nuk keni për të arritur përkushtimin e vërtetë, derisa të ndani (lëmoshë) nga ajo (pasuri) që e doni. Çfarëdo që të ndani, Allahu e di mirë atë.”[\[3\]](#)

5. Sadakaja e pastron shpirtin dhe e dëlirë atë. Allahu i Lartësuar ka thënë:

???? ?????? ?????????????????? ?????????? ?????????????????? ?????????????????? ??????

“Merr nga pasuria e tyre lëmoshë me të cilën t’i pastrosh ata dhe t’ua rrisësh veprat e mira.”[\[4\]](#)

6. Sadakaja e fut dhënësin e saj nën hije nga nxehtësia e diellit ditën e Kiametit. I Dërguari i Allahut, sal-lallahu alejhi ue sel-lem, ka thënë: *“Çdo njeri do të jetë nën hijen e sadakasë së tij, derisa të gjykohet mes njerëzve.”* (Këtë hadith e shënon Ahmedi, kurse Albani e klasifikon si autentik). Ndërsa, në hadithin e të shtatëve thuhet: *“dhe njeriu që jep sadaka fshehurazi, saqë dora e majtë nuk e di ç’jep e djathta.”* (Shënon Buhariu dhe Muslimi).

16. Sadakaja është shkak për hyrjen në xhenet. I Dërguari i Allahut, sal-lallahu alejhi ue sel-lem, ka thënë: *“O ju njerëz, përhapeni selamin, ushqeni të tjerët, mbani lidhjet familjare dhe faluni natën kur njerëzit flenë do të hyni në xhenet, të përshëndetur me selam.”* (Shënon Tirmidhiu ndërsa Albani e klasifikon autentik).

Përktheu: Almedin Ejupi

[1] Kuran, 2:274.

[2] Kuran, 2:276.

[3] Kuran, 3:92.

[4] Kuran, 9:103.

[5] Kuran, 76:8,11.